



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.28

2004

13 maj

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9215 datë 1.4.2004	Për medaljet për personelin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë	2417
Ligj nr.9216 datë 1.4.2004	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, ndryshuar me ligjin nr. 8790, datë 10.5.2001	2421
Vendim i KM nr.253, datë 30.4.2004	Për disa ndryshime e shtesa në vendimin nr.416, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave “Për administrimin dhe përdorimin e të ardhurave të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit nga privatizimi i shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorë jostrategjikë”	2429
Vendim i KM nr.258, datë 30.4.2004	Për miratimin e akteve dhe të dokumenteve kryesore të Kongresit XXII të Bashkimit Postar të Përbotshëm, Pekin 1999	2429
Vendim i KM nr.262, datë 23.4.2004	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Qendrës Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve në Babrru, Tiranë, Ministrisë së Rendit Publik, si dhe për organizimin e funksionimit të saj, dhe për një shtesë në numrin e parashikuar të punonjësve të kësaj Ministrie	2430
Vendim i KM nr.269, datë 23.4.2004	Për miratimin e strategjisë së zhvillimit të industrisë joushqimore	2431

Vendim i GJK nr.10, datë 28.4.2004	Me objekt deklarin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Zija Vuci.....	2431
	Vendim i shkurtuar për shpalljen të zhdukur të shtetasit Fatmir Xhemal Xhelili.....	2432
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasve Bardhosh Lame, Tushe Lame dhe Bartuela Lame.....	2432

LIGJ
Nr.9215, datë 1.4.2004

**PËR MEDALJET PËR PERSONELIN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Medaljet e nderit u jepen ushtarakëve shqiptarë, punonjësve civilë, pjesëtarë të Forcave të Armatosura, dhe ushtarakëve të huaj, që shquhen për merita të veçanta në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe në mbrojtje të interesave të vendit.

Neni 2

Përveç dekoratave e titujve të nderit, që Presidenti i Republikës jep sipas ligjit, për personelin e Forcave të Armatosura jepen dhe medalje nderi nga Ministri i Mbrojtjes, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm dhe komandanti i forcës.

Neni 3

Ushtarakëve dhe punonjësve civilë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë u jepen këto medalje:

1. Medalja "Për shërbime të shquara".
2. Medalja "Për pjesëmarrje në shërbime ndërkombëtare".
3. Medalja "Për shërbime të larta" për punonjësit civilë.
4. Medalja "Shpëtoj jetë".
5. Medalja "Për shërbime të veçanta".
6. Medalja "E karrierës".
7. Medalja "Komandanti".
8. Medalja "Për shërbim në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shtabin e Përgjithshëm".
9. Medalja "Nderi për shërbim ushtarak".
10. Medalja "Repart i shquar".
11. Medalja "Plagosur në luftë".
12. Medalja "E shërbimit".
13. Medalja "Për rezultate të larta në përvetësimin e programit mësimor".
14. Medalja "Qitës i dalluar".

Neni 4

Përshkrimi i medaljeve, rregullat dhe procedurat për propozimet, shqyrtimet dhe dhënien e tyre caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

KREU II

MOTIVACIONET DHE KUSHTET E DHËNIES SË MEDALJEVE

Neni 5

Medalja "Për shërbime të shquara"

Medalja "Për shërbime të shquara" u jepet nga Ministri i Mbrojtjes ushtarakëve dhe punonjësve civilë të Forcave të Armatosura, që janë dalluar për shërbime të merituar në detyrat me përgjegjësi të lartë.

Neni 6

Medalja "Për pjesëmarrje në shërbime ndërkombëtare"

Medalja "Për pjesëmarrje në shërbime ndërkombëtare" u jepet nga Ministri i Mbrojtjes ushtarakëve dhe punonjësve civilë të Forcave të Armatosura, të cilët kanë marrë pjesë, për një periudhë kohore jo më pak se 3 muaj, në operacione të ndryshme dhe paqeruajtëse, nën drejtimin e NATO-s, të Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Europian ose për shërbime të tjera të miratuara për të marrë pjesë në shtete të huaja.

Neni 7

Medalja "Për shërbime të larta" për punonjësit civilë

Medalja "Për shërbime të larta" për punonjësit civilë u jepet nga Ministri i Mbrojtjes punonjësve civilë të Forcave të Armatosura për arritje të veçanta në kryerjen e detyrave të tyre për një periudhë jo më pak se dy vjet.

Neni 8

Medalja "Shpëtoj jetë"

Medalja "Shpëtoj jetë" u jepet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ushtarakëve të dalluar për heroizëm në shpëtimin e jetës së njeriut, duke rrezikuar jetën e tyre, përfshirë rastet e operacioneve të kërkim-shpëtimit.

Neni 9

Medalja "Për shërbime të veçanta"

Medalja "Për shërbime të veçanta" u jepet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ushtarakëve, të cilët dallohen për arritje ose shërbime të merituar, por që nuk kanë marrë pjesë në betejat ushtarake.

Neni 10

Medalja "E karrierës"

Medalja "E karrierës" u jepet:

- a) nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ushtarakëve, të cilët shërbejnë në këto forca për një periudhë 25-vjeçare;
- b) nga komandanti i forcës, çdo 5 vjet, ushtarakëve që shërbejnë në Forcat e Armatosura dhe që kanë kontribuar në sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë.

Neni 11

Medalja "Komandanti"

Medalja "Komandanti" u jepet:

- a) nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ushtarakëve, që kanë kryer me sukses detyrën e komandantit të brigadës ose një detyrë të të njëjtit rang, për një periudhë jo më pak se dy vjet;
- b) nga komandanti i forcës për komandantët e batalionit;
- c) nga komandanti i brigadës për komandantin e kompanisë.

Neni 12

Medalja "Për shërbim në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shtabin e Përgjithshëm"

Medalja "Për shërbim në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shtabin e Përgjithshëm" u jepet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ushtarakëve, që kanë kryer me sukses detyrën në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shtabin e Përgjithshëm, për një periudhë jo më pak se dy vjet.

Neni 13

Medalja "Nderi për shërbim ushtarak"

Medalja "Nderi për shërbim ushtarak" u jepet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ushtarakëve, që demonstrojnë sjellje shembullore dhe kanë arritur tregues të lartë gjatë detyrës, për një periudhë 5-vjeçare.

Kjo medalje mund të jepet çdo 5 vjet nga koha e marrjes së medaljes së fundit.

Neni 14

Medalja "Repart i shquar"

Medalja "Repart i shquar" u jepet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, me propozimin e komandantit të forcës, reparteve që kanë treguar trimëri e vendosmëri të lartë gjatë përmbushjes së misionit përmes vështirësive të mëdha.

Neni 15

Medalja "Plagosur në luftë"

Medalja "Plagosur në luftë" u jepet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura ushtarakëve të plagosur gjatë luftimeve kundër armikut të Republikës së Shqipërisë.

Neni 16

Medalja "E shërbimit"

Medalja "E shërbimit" u jepet nga komandanti i forcës ushtarakëve, që dallohen për shërbime apo arritje të merituar gjatë kryerjes së detyrave.

Neni 17

Medalja "Për rezultate të larta në përvetësimin e programit mësimor"

Medalja "Për rezultate të larta në përvetësimin e programit mësimor" u jepet nga komandanti i komandës së doktrinës dhe stërvitjes, nga komandanti i forcës dhe ai i mbështjes logjistike 5 për qind të ushtarakëve të dalluar në mësimet ose gjatë zhvillimit të një kursi të caktuar.

Neni 18
Medalja "Qitës i dalluar"

Medalja "Qitës i dalluar" u jepet nga komandanti i brigadës ushtarakëve dhe njësisë, të cilët dallohen si specialistë zjarri me armët që disponon reparti, sipas standardeve të përcaktuara nga komanda e doktrinës dhe stërvitjes.

Neni 19
Dorëzimi i medaljes

Ceremonia e dorëzimit të medaljes bëhet brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit.

Dorëzimi i medaljes mund të bëhet në prani të efektivit të repartit, të pjesëtarëve të familjes dhe të të ftuarve të tjerë.

Neni 20
Mbajtja e medaljeve

Ushtarakët dhe civilët e Forcave të Armatosura, përveç medaljeve dhe dekoratave të dhëna nga institucionet dhe personalitetet e vendit, gëzojnë të drejtën të mbajnë edhe dekoratat ose medaljet e dhëna nga autoritetet e shteteve të tjera.

KREU III
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 21
Shpërblimi për medaljet

Dhënia e medaljeve shoqërohet me një shpërblim në të holla. Rregullat, kriteret dhe masa e shpërblimit përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Efektet financiare përballohen nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

Neni 22
Nxjerrja e akteve nënligjore

Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 4 dhe 21 të këtij ligji.

Neni 23
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4212, datë 26.4.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

LIGJ
Nr.9216, datë 1.4.2004

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7829, DATË 1.6.1994 “PËR
NOTERINË”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR. 8790, DATË 10.5.2001**

Në mbështetje të neneve 78 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, ndryshuar me ligjin nr. 8790, datë 10.5.2001, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 2 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 2

1.Profesionin e noterit mund ta ushtrojë çdo shtetas i Republikës së Shqipërisë, i cili plotëson këto kushte:

- a) ka kryer arsimin e lartë juridik;
- b) ka zotësi të plotë për të vepruar;
- c) është jo më pak se 26 vjeç dhe jo më shumë se 55 vjeç në çastin e dhënies së provimit të kualifikimit për marrjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit;
- ç) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për një vepër penale të kryer me dashje;
- d) nuk është larguar nga detyra apo funksioni i gjyqtarit, i prokurorit ose i nëpunësit të administratës publike për shkelje të rregullave dhe të disiplinës në punë gjatë 3 vjetëve të fundit nga data e paraqitjes së kërkesës për lejimin e ushtrimit të profesionit të noterit;
- dh) ka punuar jo më pak se 2 vjet asistent pranë një noteri;
- e) ka marrë pjesë në provimin e kualifikimit për marrjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit dhe është vlerësuar me jo më pak se 80 për qind të pikëve të caktuara për konkurrim;
- ë) është pajisur me lejen e ushtrimit të profesionit të noterit;
- f) është anëtar i një dhome noterie.

2. Shtetasit që janë deputetë me arsim të lartë juridik, ose që kanë punuar jo më pak se 2 vjet si gjyqtarë, prokurorë, noterë, avokatë, ose kanë jo më pak se 3 vjet përvojë në pozicionin e drejtuesit, këshilltarit apo të specialistit të strukturave juridike pranë Presidentit, Kuvendit, Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, Avokatit të Popullit, aparatit të Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Drejtësisë ose në atë të punonjësit akademik të brendshëm të lëndëve juridike në shkollat e larta universitare përjashtohen nga afati i parashikuar në pikën 1 shkronja “dh “ të këtij neni.”.

Neni 2

Neni 2/a shfuqizohet.

Neni 3

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 3

Dhoma Kombëtare e Noterisë njofton për vendin vakant për ushtrimin e veprimtarisë së noterit, i cili shpallet publikisht nga Ministri i Drejtësisë në Fletoren Zyrtare jo më vonë se 15 ditë nga krijimi i këtij vendi.

Plotësimi i vendit vakant duhet të realizohet nëpërmjet transferimit të noterëve dhe, nëse kjo nuk është e mundur, nëpërmjet konkurrimit të shtetasve shqiptarë që plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 2 të këtij ligji.

Në mungesë të propozimeve për transferim të noterëve dhe mbi bazën e kërkesave të parashtruara për të ushtruar veprimtarinë noteriale, Ministri i Drejtësisë organizon konkurrimin për plotësimin e vendit vakant dhe provimin përkatës të kualifikimit për ushtrimin e profesionit të noterit jo më vonë se 30 ditë nga afati i përmendur në paragrafin e gjashtë të nenit 3/ç.

Provimi i kualifikimit jepet përpara Komisionit të Kualifikimit për Noterinë, i cili përbëhet nga 3 përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, 1 përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe 1 pedagog nga Shkolla e Magjistraturës.

Ministri i Drejtësisë përcakton datën e konkurrimit, rregullat për funksionimin e Komisionit të Kualifikimit për Noterinë, kriteret dhe procedurat e organizmit të provimit, si dhe bën shpalljen e rezultateve të provimit.”.

Neni 4

Pas nenit 3 shtohen nenet 3/a dhe 3/b me këtë përmbajtje:

“Neni 3/a

Ministri i Drejtësisë, për çdo vend vakant të shpallur, në mbështetje të rezultateve të provimit, i jep fituesit të konkurrimit lejen për ushtrimin e profesionit të noterit, duke u shprehur edhe për njësinë vendore ku do të ushtrojë veprimtarinë e tij.

Shtetasi që është shpallur fitues për ushtrimin e profesionit të noterit në më shumë se një vend vakant, duhet që brenda 3 ditëve nga shpallja e rezultatit të provimit të njoftojë me shkrim Ministrinë e Drejtësisë për zgjedhjen e tij.

Nëse nuk përmbushet detyrimi i përcaktuar në paragrafin e dytë të këtij neni, Ministri i Drejtësisë cakton vendin vakant që do të plotësojë fituesi, si dhe vendet e tjera vakante që do të plotësohen nga konkurrentët e renditur menjëherë pas fituesit, por që kanë marrë mbi 80 për qind të pikëve.

Neni 3/b

Leja për ushtrimin e profesionit të noterit, së bashku me të dhënat përkatëse, regjistrohen në regjistrin e noterëve pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe në Dhomën Kombëtare të Noterisë.

Shtetasi i pajisur me lejen e ushtrimit të profesionit të noterit nga Ministri i Drejtësisë duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë noteriale në vendin e shpallur vakant jo më vonë se 60 ditë nga data e lëshimit të lejes. Me kalimin e këtij afati, sipas njoftimit nga Dhoma Kombëtare e Noterisë ose vetë i interesuari, leja për ushtrimin e veprimtarisë noteriale shfuqizohet dhe Ministri i Drejtësisë, mbështetur në rezultatet e konkurrimit, i jep lejen e ushtrimit të profesionit të noterit shtetasit të renditur menjëherë pas fituesit të konkurrimit. Në rast se edhe ky i fundit nuk e fillon ushtrimin e veprimtarisë së tij noteriale brenda afatit 60-ditor, leja për ushtrimin e profesionit të noterit shfuqizohet dhe nëse nuk ka fitues të tjerë që kanë marrë mbi 80 për qind të pikëve, për plotësimin e vendit vakant zhvillohet një konkurrim i ri.”.

Neni 5

Neni 3/a bëhet neni 3/c dhe ndryshohet si më poshtë:

“Neni 3/c

Noteri, në ushtrimin e veprimtarisë së vet noteriale, mund të asistohet nga një ose më shumë asistentë.

Brenda 15 ditëve nga lidhja e kontratës me asistentin, noteri duhet të depozitojë në dhomën e noterisë ku është anëtar, në Dhomën Kombëtare të Noterisë dhe në Ministrinë e Drejtësisë kopje të kontratës dhe dokumentacionin ligjor të kërkuar për asistentët.

Përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së tij, asistenti duhet të regjistrohet në regjistrin përkatës të Ministrisë së Drejtësisë dhe të depozitojë dokumentacionin e kërkuar prej saj.

Asistenti që ka më shumë se 2 vjet në ushtrimin e kësaj veprimtarie, pajiset me certifikatë të lëshuar nga Dhoma Kombëtare e Noterisë pasi të jetë marrë edhe vlerësimi pozitiv i noterit, pranë të cilit ka punuar asistenti.

Asistenti i pajisur me certifikatë dhe që plotëson kushtet e tjera të përcaktuara në nenin 2 të këtij ligji, ka të drejtë të marrë pjesë në konkurrimet e organizuara për ushtrimin e profesionit të noterit në plotësimin e vendeve vakante.

Ministri i Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë caktojnë bashkërisht rregulla të hollësishme lidhur me procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe caktimit të asistentit pranë noterit, si dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre gjatë periudhës së ushtrimit të kësaj veprimtarie.”.

Neni 6

Pas nenit 3/c shtohet neni 3/ç me këtë përmbajtje:

“Neni 3/ç

Transferimi i noterit bëhet vetëm me kërkesën e tij.

Noteri që kërkon të transferohet, regjistrohet në listën e noterëve që janë në pritje për transferim, e cila mbahet nga Dhoma Kombëtare e Noterisë.

Dhoma Kombëtare e Noterisë, brenda 30 ditëve nga regjistrimi i kërkesës, i dërgon Ministrisë së Drejtësisë njoftimin zyrtar për këtë regjistrim dhe një kopje të kërkesës përkatëse të noterit që kërkon të transferohet.

Noterët kanë të drejtën e transferimit të veprimtarisë së tyre në një tjetër juridiksion rrethi gjyqësor në përputhje me radhën e regjistrimit të kërkesave përkatëse të transferimit për atë juridiksion, që rezulton nga lista e përmendur në paragrafin e dytë të këtij neni.

Lejimi i një noterit për të transferuar veprimtarinë e vet në juridiksionin e një rrethi tjetër gjyqësor bëhet nga Ministri i Drejtësisë, pasi ka marrë më parë mendimin me shkrim të Dhomës Kombëtare të Noterisë për këtë transferim. Dhoma Kombëtare e Noterisë duhet të japë mendimin e saj me shkrim brenda 15 ditëve nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare të vendit vakant të noterit në atë juridiksion.

Ministri i Drejtësisë lejon transferimin e veprimtarisë së një noterit jo më vonë se 30 ditë nga data e shpalljes në Fletoren Zyrtare të vendit vakant të noterit në atë juridiksion.

Në asnjë rast transferimet nuk mund të përbëjnë më shumë se 50 për qind të vendeve vakante për çdo dhomë noterie.

Noteri i transferuar duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë noteriale në rrethin gjyqësor ku është transferuar jo më vonë se 60 ditë nga data e daljes së urdhrit të Ministrit të Drejtësisë për transferimin e tij. Me kalimin e këtij afati, noterit të transferuar i hiqet leja për ushtrimin e profesionit të noterit.”.

Neni 7

Neni 6 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 6

Heqja e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit bëhet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë kur:

- a) heq dorë me kërkesën e tij nga ushtrimi i profesionit të noterit;
- b) mbush moshën 65 vjeç;
- c) humbet zotësinë e plotë për të vepruar;
- ç) bëhet i paaftë për të ushtruar veprimtarinë për shkak sëmundjeje për një kohë më të gjatë se 6 muaj gjatë një viti;
- d) vërtetohet se është emëruar në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në nenin 2 të këtij ligji;
- dh) dënohet për një vepër penale të kryer me dashje;
- e) tregon paaftësi profesionale në kryerjen e detyrës;
- ë) nuk ushtron veprimtarinë noteriale për një periudhë kohe deri në 30 ditë rresht pa njoftuar me shkrim Dhomën Kombëtare të Noterisë dhe Ministrinë e Drejtësisë;
- f) shkel rëndë ose në mënyrë të përsëritur rregullat që lidhen me ushtrimin e profesionit të noterit, të parashikuara në këtë ligj dhe në Kodin e Etikës Profesionale, të propozuar nga Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe të miratuar nga Ministri i Drejtësisë;
- g) i është dhënë në mënyrë të përsëritur masa disiplinore e parashikuar në nenin 7 shkronja “b” të këtij ligji;
- gj) i është dhënë paraprakisht një nga masat disiplinore të shkronjave “c” dhe “ç” të nenit 7 të këtij ligji dhe kjo masë disiplinore nuk është parashikuar.”.

Neni 8

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 7

Për shkelje të dispozitave që rregullojnë ushtrimin e profesionit dhe të veprimtarisë së noterit, ndaj tyre jepen këto masa disiplinore:

- a) vërejtje;
- b) gjobë nga 5 000 deri në 50 000 lekë;
- c) vërejtje me paralajmërim për heqje të lejes për ushtrimin e profesionit të noterit;
- ç) heqje e lejes së ushtrimit të veprimtarisë së noterit për një periudhë deri në 2 vjet;
- d) heqje e lejes së ushtrimit të veprimtarisë së noterit.”.

Neni 9

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 8

Masat disiplinore të parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të nenit 7 të këtij ligji jepen nga Ministri i Drejtësisë nëse vërtetohen shkelje nga verifikimet dhe inspektimet e kryera kryesisht prej tij ose nga dhoma e noterisë ku është anëtar noteri, i cili procedohet disiplinarisht. Në rast se dhoma e noterisë refuzon të japë masën disiplinore pa shkaqe të motivuara, me kërkesë të personit të dëmtuar, ajo mund të jepet nga Ministri i Drejtësisë.

Masat disiplinore të parashikuara në shkronjat “c” dhe “d” të nenit 7 të këtij ligji jepen nga Ministri i Drejtësisë, me propozimin e dhomës së noterisë ku është anëtar noteri që do të procedohet disiplinarisht ose kryesisht, pasi të ketë marrë mendimin me shkrim të kësaj dhome.

Masat disiplinore jepen brenda 6 muajve nga data e konstatimit të shkeljes, por jo më vonë se 3 vjet nga momenti i kryerjes së saj.

Masat disiplinore jepen sipas një procedure, e cila garanton të drejtën për t’u informuar, për të kërkuar sqarime rreth fakteve, për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur.”.

Neni 10

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 9

Kundër Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë për dhënien e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit, për transferimin e noterit ose për përsëritjen e konkurrencës për vendet vakante, për procedurën e zhvillimit të provimit të kualifikimit, si dhe për masat disiplinore të dhëna ndaj noterit mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën e Apelit Tiranë. E njëjta rrugë ankimore ndiqet edhe për masat disiplinore të dhëna nga dhoma e noterisë ku bën pjesë noteri, ndaj të cilit është marrë masa disiplinore.

Urdhrat e Ministrit të Drejtësisë që përmbajnë masa disiplinore, pas kalimit të afatit të ankimit ose kur lihen në fuqi nga gjykata, regjistrohen në regjistrin e noterëve pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë. Një kopje e tyre depozitohet në dosjen e noterit.”.

Neni 11

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 10

Masat disiplinore të dhëna sipas nenit 7 të këtij ligji konsiderohen se nuk janë dhënë në rastet kur nga data e dhënies së tyre:

- a) ka kaluar 1 vit për masën disiplinore të vërejtjes;
- b) kanë kaluar 2 vjet për masën disiplinore të vërejtjes me paralajmërim për heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit;
- c) kanë kaluar 3 vjet për masën disiplinore për heqjen e përkohshme të lejes së ushtrimit të profesionit të noterit.”.

Neni 12

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 12

Noteri mund të ushtrojë veprimtarinë e vet vetëm në një zyrë noterie.

Në një zyrë noterie duhet të punojë vetëm një noter dhe në ushtrimin e veprimtarisë ai mund të ndihmohet nga asistentët ose personeli administrativ. Dy ose më shumë noterë mund të punojnë bashkë në një zyrë noterie vetëm me miratimin e Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë, në rastet e transferimit ose të ndryshimit të vendndodhjes së zyrës së noterisë, noteri duhet të lajmërojë me shkrim Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomën Kombëtare të Noterisë brenda 15 ditëve nga fillimi i veprimtarisë në adresën e re.

Noteri duhet të sigurojë zyra dhe mjedise të sigurta e të përshtatshme për të ushtruar veprimtarinë dhe profesionin e noterit. Kushtet minimale që duhet të plotësojë një noter për vendndodhjen, mjediset, pajisjet dhe paraqitjen e zyrës së noterisë caktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, pasi të ketë marrë mendimin me shkrim të Dhomës Kombëtare të Noterisë.”.

Neni 13

Neni 16 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 16

Numri i përgjithshëm i noterëve që ushtrojnë veprimtarinë tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë duhet të jetë në përpjesëtim të arsyeshëm me numrin e përgjithshëm të popullsisë.

Ministri i Drejtësisë, në bazë të numrit të popullsisë dhe të vëllimit të punës së veprimtarisë noteriale, pasi të ketë marrë mendimin me shkrim të Dhomës Kombëtare të Noterisë, cakton çdo dy vjet numrin e përgjithshëm të noterëve për çdo rreth gjyqësor, si dhe mbulimin përkatës për çdo bashki së bashku me komunat pranë saj.

Noteri nuk mund të ushtrojë veprimtarinë e tij jashtë territorit të njësive vendore të caktuara në urdhrin e Ministrit të Drejtësisë, me përjashtim të rasteve të veçanta kur një gjë e tillë miratohet, për një periudhë kohore jo më shumë se 60 ditë, nga të dy dhomat përkatëse të noterisë. Kryerja nga noteri e akteve dhe e veprimeve noteriale jashtë territorit të përcaktuar për ushtrimin e veprimtarisë së tij nuk sjell pavlefshmërinë tyre.

Ministria e Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, veç e veç, mbajnë regjistra për noterët dhe asistentët, si dhe administrojnë dokumentacionin që lidhet me marrjen dhe heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit, transferimet e tyre, përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe ecurinë disiplinore të noterëve dhe asistentëve.

Forma dhe përmbajtja e regjistrave të noterëve dhe asistentëve, mënyra dhe procedurat e mbajtjes së tyre dhe elementet e dokumentacionit që përfshihen në dosjet e noterëve dhe asistentëve caktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, pasi të ketë marrë mendimin me shkrim të Dhomës Kombëtare të Noterisë.”.

Neni 14

Në fund të nenit 17 shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

“Dhoma Kombëtare e Noterisë pajis me vulë fituesin e konkurrimit ose noterin e transferuar për vendin vakant. Shpenzimet për përgatitjen e vulave përballohen nga noteri.

Forma, përmbajtja dhe karakteristikat e tjera të vulave, si dhe rregullat për pajisjen dhe administrimin e tyre përcaktohen nga Ministri i Drejtësisë, pasi të ketë marrë mendimin me shkrim të Dhomës Kombëtare të Noterisë.”.

Neni 15

Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 20

Në rast vdekjeje ose mase disiplinore të dhënë sipas shkronjave “ç” dhe “d” të nenit 7 të këtij ligji, personi i autorizuar nga Ministri i Drejtësisë dhe dhoma përkatëse e noterisë merr në dorëzim regjistrat dhe aktet noteriale të arkivës së noterit dhe ia dorëzon për ruajtje një noteri të të njëjtit rreth gjyqësor.

Vulat e noterit, të cilit i është dhënë masa disiplinore, sipas shkronjës “ç” të nenit 7 të këtij ligji, mbahen në Ministrinë e Drejtësisë dhe i dorëzohen noterit me urdhër të Ministrit të Drejtësisë pas shlyerjes së masës disiplinore.

Vulat e noterit të vdekur dhe të atij që i është dhënë masa disiplinore e heqjes së ushtrimit të veprimtarisë së noterit nxirren jashtë përdorimit me proceverbal nga personat e autorizuar nga Ministri i Drejtësisë, dhoma përkatëse e noterisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë.

Në rast moszbatimi vullnetar, urdhri i Ministrit të Drejtësisë për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur në paragrafin e parë të këtij neni, përbën titull ekzekutiv dhe ngarkohet zyra e përmbarimit me ekzekutimin e tij.”.

Neni 16

Në fund të nenit 22 bëhen këto shtesa:

- “ - të kërkojë dhe të shpërblehet për punën e kryer;
- të organizojë ose të marrë pjesë në organizime profesionale kolektive.”.

Neni 17

Neni 25 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 25

Noteri duhet të lidhë kontratë sigurimi për përgjegjësinë e tij ndaj palëve të treta për shkak të ushtrimit të veprimtarisë noteriale.”.

Neni 18

Paragrafi i dytë i nenit 26 shfuqizohet.

Neni 19

Neni 29 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 29

Noterët organizohen profesionalisht në nivel vendor nëpërmjet dhomave të noterisë që funksionojnë pranë një ose disa rretheve gjyqësore dhe në nivel kombëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, të cilat janë persona juridikë.”

Neni 20

Neni 30 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 30

Dhoma e noterisë në nivel vendor përbëhet nga të gjithë noterët që janë caktuar të ushtrojnë veprimtarinë noteriale në juridiksionin e saj.

Numri minimal i noterëve për një rreth gjyqësor caktohet bashkërisht nga Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe Ministria e Drejtësisë.

Për çdo juridiksion të caktuar nga Ministri i Drejtësisë, sipas nenit 16 të këtij ligji, nuk mund të ketë më shumë se një dhomë noterie.

Kur numri i noterëve të caktuar për një rreth gjyqësor është më i vogël se numri minimal i tyre, i caktuar sipas paragrafit të mësipërm, nuk mund të krijohet dhomë noterie. Noterët e këtij rrethi gjyqësor anëtarësohen në dhomën e noterisë të rrethit gjyqësor më të afërt, sipas përcaktimit të bërë nga Ministri i Drejtësisë, pasi të ketë marrë mendimin me shkrim të Dhomës Kombëtare të Noterisë.”

Neni 21

Në nenin 67 shkronja “e” riformulohet si më poshtë:

“e) akti ose veprimi noterial nuk përmban nënshkrimin e palëve ose nuk është nënshkruar dhe vulosur me të dyja vulat nga noteri.”.

Neni 22

Në përjashtim të kushteve dhe procedurave për plotësimin e vendit vakant, sipas neneve 3/a dhe 3/ç të këtij ligji, si dhe të administrimit dhe marrjes në dorëzim të regjistrave dhe akteve noteriale, sipas nenit 20 të tij, plotësimi i vendit vakant që krijohet për shkak të heqjes dorë nga ushtrimi i profesionit, plotësimit të moshës 65 vjeç ose vdekjes së noterit, i ofrohet nga Ministri i Drejtësisë bashkëshortes/bashkëshortit ose fëmijëve të tij/saj, nëse ata fitojnë mbi 80 për qind të pikëve të konkurrimit ose ushtrojnë profesionin e noterit.

Në rastin e parashikuar në paragrafin e mësipërm, noteri ka të drejtën të kërkojë t'i dorëzohen regjistrat dhe aktet noteriale të arkivit të noterit që nuk ushtron më profesionin e tij.

Neni 23

Në të gjitha dispozitat e ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, ndryshuar me ligjin nr.8790, datë 10.5.2001, fjala “stazhier” zëvendësohet me fjalën “asistent”.

Neni 24

Dispozitë kalimtare

Periudha e ushtrimit të veprimtarisë së stazhierit ose asistentit, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, është e vlefshme për efekt të ecurisë së afatit dyvjeçar të punës së asistentit.

Neni 25

Ngarkohen Ministri i Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të neneve 3/c paragrafi i fundit, 16 paragrafi i fundit dhe 17 paragrafi i fundit.

Neni 26

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4213, datë 26.4.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

VENDIM
Nr.253, datë 30.4.2004

PËR DISA NDRYSHIME E SHITESA NË VENDIMIN NR.416, DATË 9.7.1998 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR ADMINISTRIMIN DHE PËRDORIMIN E TË ARDHURAVE TË MINISTRISË SË EKONOMISË PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT NGA PRIVATIZIMI I SHOQËRIVE TREGTARE, QË VEPROJNË NË SEKTORË JOSTRATEGJIKË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.8334, datë 23.4.1998 “Për privatizimin e shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorë jostrategjikë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.416, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Emërtimi “... Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit...” zëvendësohet me “... Ministrisë së Ekonomisë...”.

2. Në pikën 2, pas shkronjës “ç” të shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d. shpenzimet për shoqëritë anonime e ndërmarrjet shtetërore të shpallura në likuidim dhe atyre në proces privatizimi, që nuk kanë mundur të shiten.

Dhënia e këtyre fondeve të bëhet sipas preventivave përkatëse të shpenzimeve, të argumentuara nga ministrinë e linjës.”.

3. Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Kontrolli i administrimit dhe i përdorimit të këtij fondi të bëhet në përputhje me rregullat që zbatohen me fondet buxhetore, sipas ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe të akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij.

Ky fond të përdoret brenda limitit të miratuar në buxhetin vjetor të Ministrisë së Ekonomisë, në titullin “Mbështetje për ndërmarrjet në likuidim”.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.258, datë 30.4.2004

PËR MIRATIMIN E AKTEVE DHE TË DOKUMENTEVE KRYESORE TË KONGRESIT XXII TË BASHKIMIT POSTAR TË PËRBTOSHËM, PEKIN 1999

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e akteve dhe të dokumenteve kryesore të Kongresit XXII të Bashkimit Postar të Përbotshëm, Pekin 1999, si më poshtë vijon:

1. Konventa postare e përbotshme.

2. Protokolli i gjashtë shtesë i Kushtetutës së Bashkimit Postar të Përbotshëm.
 3. Rregullore e përgjithshme e Bashkimit Postar të Përbotshëm.
 4. Rregullore e marrëveshjes së shërbimeve të pagesave me postë.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.262, datë 23.4.2004

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË QENDRËS KOMBËTARE
PRITËSE TË AZILKËRKUESVE NË BABRRU, TIRANË, MINISTRISË SË RENDIT
PUBLIK, SI DHE PËR ORGANIZIMIN E FUNKSIONIMIN E SAJ, DHE PËR NJË SHITESË
NË NUMRIN E PARASHIKUAR TË PUNONJËSVE TË KËSAJ MINISTRIE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8492, datë 27.5.1999 “Për të huajt”, të ndryshuar, të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të shkronjës “e” të nenit 3 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qendra Kombëtare Pritëse e Azilkërkuesve në Babrru, Tiranë të kalojë në varësi dhe përgjegjësi administrimi nga Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, Ministrisë së Rendit Publik dhe të shërbejë për të pritur e për të sistemuar azilantët në Republikën e Shqipërisë.
 2. Qendra Kombëtare Pritëse e Azilkërkuesve është person juridik publik buxhetor, me zë të veçantë në buxhetin e Ministrisë së Rendit Publik.
 3. Struktura dhe organika e Qendrës Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve miratohet nga Ministri i Rendit Publik dhe për funksionimin e saj për vitin 2004, numrit të parashikuar të punonjësve të Ministrisë së Rendit Publik t’i shtohen edhe 15 veta.
 4. Emërimi dhe shkarkimi i punonjësve të Qendrës Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve bëhen me urdhër të Ministrit të Rendit Publik.
 5. Ruajtja dhe sigurimi i kësaj qendre kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
 6. Efektet financiare për pagat, sigurimet dhe shpenzimet operative të përballohen nga buxheti i vitit 2004, miratuar për Ministrinë e Rendit Publik.
 7. Ngarkohen Ministri i Rendit Publik, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.269, datë 23.4.2004

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT TË INDUSTRISË JOUSHQIMORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e strategjisë së zhvillimit të industrisë joushqimore, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.10, datë 28.4.2004

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 28.4.2004, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore kërkesën e bërë nga kryetari i Gjykatës Kushtetuese.

OBJEKTI: Deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, zotit Zija Vuci.

BAZA LIGJORE: Neni 127, pikat 1-c e 2 të Kushtetutës dhe neni 9, pika 2 e ligjit nr.8577, datë 10.2.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatimin e bërë nga kryetari dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Zoti Zija Vuci është zgjedhur gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese me datën 16.12.1994 për një periudhë 12-vjeçare, në bazë të nenit 30 të ligjit “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”. Në datën 25.4.2004 zoti Zija Vuci ka mbushur moshën 70 vjeç.

- Sipas nenit 127 pika 1-c e Kushtetutës, mandati i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese mbaron kur mbush 70 vjeç. Në pikën 2 të këtij neni përcaktohet se mbarimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese deklarohet me vendim të saj.

Duke qenë kështu, Gjykata Kushtetuese çmon se mandati për zotin Zija Vuci duhet të deklarohet i mbaruar për shkak të mbushjes së moshës. Meqenëse vendi i tij mbetet vakant, Presidenti i Republikës, në bazë të nenit 127-3 të Kushtetutës emëron, me pëlqimin e Kuvendit, një gjyqtar të ri, i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të zotit Zija Vuci.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131 e 134 të Kushtetutës, si dhe të neneve 9, 26 e 72 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë“, unanimisht,

VENDOSI:

- Të deklarojë mbarimin e mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, zotit Zija Vuci, sepse ka mbushur moshën 70 vjeç.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.2071, datë 11.12.2003 ka vendosur shpalljen të zhdukur të shtetasit Fatmir Xhemal Xhelili, i datëlindjes 10 maj 1974.

KËRKESË

Shtetasi Shkëlqim Lame, lindur dhe banues në Vlorë, kërkon të shpallen të vdekur shtetasit Bardhosh Lame, Tushe Lame dhe Bartuela Lame.

KËRKUESI
Shkëlqim Lame

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
13.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

14.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
15.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

Së shpejti në botim, përmbledhje në fushën e taksave dhe tatimeve

Doli nga shtypi më 13.5.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë